



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL  
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Bilisht, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: "Rikonstruksion Shkolla fillore "Myrteza Sala" Bilisht Devoll"**  
me fond limit: 91 833 096 (nentedhjetë e një milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e  
nentedhjetë e gjashtë) leke pa tvsh.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): - Punime  
ndërtimi për shkolla

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit  
78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit  
publik", autoriteti/enti kontraktor, **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe  
miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me  
përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

#### **Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

*c. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Kriteri (1- a) është vendosur në baze të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri 1-c është vendosur në baze të nenit 39 pika 7 germa a të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

## **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Sipas Shtojcës 8.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091,

datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2022** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2022, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontrates.***

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

**-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**a. Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

-Formulari i vlerësimit

-Kontratë punimesh;

-Situacion përfundimtar;

-Akt-kolaudimi;

- Certifikatën e marrjes në dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

**b. Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

- Formulari i vlerësimit
- Kontratën e punimeve,
- situacionin përfundimtar,
- aktin e kolaudimit, (ne rastet kur ky dokumentacion leshohet)
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- faturën tatimore te Situacionit perfundimtar.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
  - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
  - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**1.3.2** Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP – 1/A (Punime gërmimi ne toke.)
- NP – 2/C (Ndertime cvile dhe industriale)
- NP –3/B (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasade)
- NP –11/A (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)
- NP – 12/A(Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
-

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

- NS – 1/A (Punime per prishjen e ndertimeve)
- NS –2/A (Impiant hidro-sanitar, guzhina, lavanteri, mirembajtje e tyre)
- NS –3/A (Impiant ngritëse dhe trasportues(anshensore, shkalle levizese, trasportuese)
- NS –4/B (Punime rifinature te muratures dhe te lidhura me to, rifinature me materiale druri, plastike, metalike, dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)
- NS – 8/A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri)
- NS –12/A (Impiant teknologjik, termik dhe kondicionimit)
- NS –13/A (Impiant dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)
- NS-14/A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)
- NS -18/ A (Punime topogjeodezike)
- NS- 19/A (Sisteme kundra zhurmes per infrastrukture)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

*Pikat e licensave janë përcaktuar në bazë të zerave të pershkruara në preventivin e projektit.*

*Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.*

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<i>NP-1</i>	<i>Punime gjurmimi në tokë.</i>	<i>Punime gjurmimi dhe</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>

NP-2	Ndertime civile dhe industriale	Punime per ndertimin e ambjenteve ndihmese te palestres	C	51-100 milion
NP-3	Rikonstr. dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Punime per rikonstruksionin e palestres se vogel, Punime per rikonstruksionin e palestres se madhe	B	21-50 milion
NP-11	Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Punime elektrike ne ambjentet e jashtem (f.v. shtylla metalike për ndriçim etj)	A	0-20 milion
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor ne te gjithë zonen perreth saj duke pasur parasysh pozicionimin e saj ne zone urbane dhe brenda rrethimit te shkolles dhe sasise se madhe te mbetjeve te gjeneruara nga punimet e prishjeve dhe germimeve.	A	0-20 milion
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve	Prishje mure, soleta, shtresa, suvatime, parketi, davancale, tavane druri etj.	A	0-20 milion
NS-2	Impiante hidro-termosantare dhe mirembajtja e tyre	Punime Hidro-Santare	A	0-20 milion
NS-3	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)		A	0-20 milion
NS-4	Punime rifiniture muratures dhe lidhura me rifinitura material druri plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknologjike ndertuese	Ndertim mur tulle, suvatime, patinime, lyerje, veshje fasade me kapot, punime grafiato etj	B	21-50 milion
NS-8	Ndërtime parafabrikat beton të armuara	Punime struktura mbajtese druri çatia, konstruksione metalike te parapergatitura etj	A	0-20 milion

	<i>struktura metal dhe druri</i>			
NS-14	<i>Impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV</i>	<i>Rrjeti i brendshem elektrik dhe telefonise</i>	A	0-20 milion
NS-12	<i>Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit</i>	<i>Sistemi i ngrohjes</i>	B	21-50 milion
NS-18	<i>Punime topogjeodezike.</i>	<i>Punimet per ndertimin e dhe pozicionimin e ambjenteve te reja ndihmese te palestres, te fushave te reja paraqesin nevojen e punimeve topogjodezike</i>	A	0-20 milion
NS-19	<i>Sisteme kundra zhurmes per infrastrukture</i>	<i>Montimi i materialeve izoluese (dritare dopio xham, veshje me polisteron fasade)</i>	A	0-20 milion

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 120 (njëqind e njëzetë) për periudhën Dhjetor 2021 - Korrik 2022 të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Dhjetor 2021 - Korrik 2022.

b) List pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën Dhjetor 2021 - Korrik 2022.

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezultoi se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen 120 punonjës.



**2.3.5** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si Drejtues teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për (Dhjetor 2021 - Korrik 2022) stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2(dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1(një) Inxhinier Gjeodet
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- 1(një) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinier Mekanik
- 1(një) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektronik

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

- a. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2021 - Korrik 2022 të shoqëruar me kontratë pune, diplome dhe Libreze Pune, stafin mbështetës si më poshtë:
- 2 (dy) inxhinier ndertimi, profile gjeoteknik
  - 1 (nje) inxhinier mekanik,
  - 1 (nje) gjeodet
  - 1 (nje) Arkitekt
  - 1(nje) inxhinier telekomunikacioni

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë

kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Drejtimesit teknik kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve persa kohe ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

- Inxhinier Ndërtimi 2(dy)

Kerkohet Inxhinieri i ndërtimit pasi kemi të bëjmë me rikonstrukcion total të objektit. Referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri i ndërtimit gjatë gjithë periudhës të zbatimit të punimeve.

- Inxhinier Gjeodet 1(një)

Referuar preventivit të punimeve dhe projektit të zbatimit, janë parashikuar punime për ndërtimin e palestres, punime për sistemimin dhe organizimin e oborrit të shkollës dhe përcaktimin saktë të hapësirave të cilat do të përdoren si terene sportive të hapura etj. Të gjitha punimet e mësipërme janë punime të cilat kërkojnë rilevime, piketime të sakta topografike, azhurnime të ndryshme si dhe caktimin e kuotave të kërkuara, sipas projektit të zbatimit. Këto punime kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga një inxhinier gjeodet për të ruajtur kualitetin e ndërtimit dhe parandalimin e devijimeve.

- Inxhinier Hidroteknik 1(një)

Kerkohet Inxhinieri pasi kemi të bëjmë me rikonstrukcion total të objektit. Referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri hidroteknik për punimet e kanalizimit të ujërave të shiut, kanalizimin e ujërave të zeza dhe lidhjet komplekse të ujit të pijshëm dhe shpërndarja e tyre nëpër objekt.

- Inxhinier Elektrik 1(një)

Kerkohet inxhinieri elektrik, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen instalime elektrike, do të kemi ndryshime linjash elektrike dhe ndryshim ndriçimi në të gjitha ambientet e shkollës, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri elektrik gjatë gjithë periudhës të zbatimit të punimeve.

- Inxhinier Elektronik 1(një)

Kerkohet inxhinieri elektronik, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të vendosen në vepe pajisje kompjuterike të cilat do të shërbejnë për vendosjen në funksion dhe për kontrollin e sistemeve për mbrojtjen nga zjarri, të ngrohjes, të kondicionimit etj, të cilat kërkojnë detyrimisht praninë nga inxhinieri elektronik i cili do të realizojë vendosjen në gjendje pune të tyre.

- Inxhinier Mekanik 1(një)

Kerkohet inxhinieri mekanik, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime të sistemit ngrohje-ftohje, radiatorët punime të strukturave metalike nëpër strehat e objektit dhe ambientet sportive. E kemi kërkuar këto inxhinier për arsye se mund të ketë problematika gjatë zbatimit të punimeve dhe mund të ketë ndryshime dhe rregullime të cilave mund t'i përgjigjet

gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve.

- 1 (një) inxhinier Mjedisi- eshte e nevojshme qe gjate fazes se ndertimit autoriteti kontraktor te kete sigurine per mbarvajtjen e punimeve lidhur me ndotjen mjedisore, ndotjet akustike,, menaxhimi i mbetjeve dhe materialeve qe dalin nga germimet, mbushjet etj. Nje inxhinier mjedisi mund te organizoje punen ne menyre te tille qe te minimizojë ndotjet pasi mirqenia e banoreve eshte paresore per institucionin tone.

- Arkitekt 1(një)

Kerkohet inxhinieri Arkitekt, pasi do te jete ne mbikqyrje te objektit nga ana estetike e jashtme dhe ambienteve te brendshme per realizimin e saj sipas projektit te zbatimit si dhe do te jape zgjidhje per problematikat qe do te dalin gjate zbatimit te objektit per korigjimet ne projekt, dhe do ti propozojë direkt Autoritetit Kontraktor.

- Inxhinier telekomunikacioni 1(një)

Kerkohet inxhinieri telekomunikacioni pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen intalime linjash kompjuterike ,telefornike dhe citofonie , te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri telekomunikacioni gjate gjithë periudhes te zbatimit te punimeve.

2 (dy) inxhinier ndertimi, profile gjeoteknik

Kerkohen 2 inxhinier ndertimi profil gjeoteknik si staf meshtetes te cilet do te zbatojne punimet lidhur me ndertimin e themeleve te palestres dhe ambientit teknik si dhe do te mbikqyrin punimet e shtresave qe do te jene nen presionin e ngarkesave . Koha e shkurter ne dispozicion sipas grafikut te punimeve dhe ne dy objekte njekohesisht kerkon stafin mbeshtetes prej dy inxhinierash te ketij profili.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te punesuar të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, te shoqeruar me kontrate pune, diploma, stafin mbështetës si më poshtë:

- 1 (nje) Ekspert mjedisi te pajisur me Certifikate “Per Vlersimin e ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor

***Ky krüter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Qëllimi për vendosjen e këtij kriteri është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve. Vlerësimin e ndikimeve

negative mjedisore në kohën e duhur dhe parandalimin e tyre.

Duke qënë se punimet do të kryhen pandërprerë aktivitetin e përditshëm të punës dhe në prani të shumë personave afër dhe Brenda kantierit të ndërtimit dhe duke pasur parasysh vendin e ndërtimit, është parë e nevojshme disponimi I ekspertit të ndikimit në mjedis. Në pikën 4, Nenin 24 të ligjit Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” përcaktohet se licencat e këtyre ekspertëve përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës së ligjit për licencat.Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor.

**2.3.7** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"
- Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe çertifikatë përkatëse për 1 (një) specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.
- 2 (dy) punonjes si "Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilesise."

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet..... “Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

AK ka si qëllim të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë nga operatori ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet pasjes së një stafi të kualifikuar për të ndërhyrë në raste emergjence dhe dhenien e menjehershme të ndihmes së parë në raste aksidentesh. Për incidentet gjatë ndërtimit të veprave është e nevojshme prania e dy ekstreteve në të pakten dy fronte pune , të cilët do të monitorojnë proceset e punës për të parandaluar demtimin e punetoreve apo banoreve të zonës si dhe dhenien e ndihmes së parë .

Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri" (i ndryshuar), , citohet: “Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me

rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta”

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyrues, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në ndërtimet e reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të jetë i licencuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

**2.3.7.1** Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë të Administratorit të shoqërisë Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, i cili/të cilët të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet dhe të jetë i pajisur me Diplomë, Kontratë pune, Librezë pune.

*Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.*

*Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se Për projekte me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Murator 3
- Hekurkthyes 1
- Saldator 2
- Hidraulik 2
- Karpentier 2
- Mekanik 1
- Elektracist 3
- Teknikë Ndërtimi 2

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit. Kriteri për punonjesit e mesiperem lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve te kualifikuar të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 629 Datë 15.07 2015“Për Miratimin E Manualeve Teknike Të Çmimeve Të Punimeve Të Ndërtimit Dhe Të Analizave Teknike Të Tyre” (I ndryshuar). Konkretisht numri I punonjesve eshte ne perputhje me volumet e punes dhe llojit te tyre.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 10 (dhjete) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit. Specialistet e mesiperem jane vendosur ne perputhje me llojin e kontrates, analiza e zerave te punimeve dhe objektin qe ndertohtet me nje numer te mjaftueshem per realizimin me sukses te punimeve.Duke pasur parasyh numrin dhe llojin e makinerive qe perkojne me oret e punes sipas zerave te analizes teknike , grafikun e punimeve eshte vendosur edhe numri i manovratoreve.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).  
(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)
- b) Çertifikatën për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001/2011 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- c) Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001-2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- d) Standard për menaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë **OHSAS 18001-2007, (ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 .

i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

“ Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar ”.

Për ISO 50001/2011 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është t’i mundësojë AK të ndjekë një qasje

sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin dhe konsumin e energjisë.

Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Devoll si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015 , standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore:

- Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësisë ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë,

- Standardet Operative - që masin harxhimin e burimeve natyrore dhe energjisë në proceset operative të kompanisë, dhe

- Standardet e Sistemit të Mjedisit - që masin ndotjet e ndryshme nga mbetjet.

Bashkia Devoll si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

Për ISO OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001-2018

Ky standart përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mirë të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

**2.3.11** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Leje dhe Licenca të lëshuara nga QKL, si mëposhtë:

- Licencë Kodi III.2.B “Per Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”
- Licencë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL. Kodi 1.2.A.

**Argumentimi:** 1-Qëllimi për vendosjen e këtij kriteri është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve. Vlerësimin e ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe parandalimin e tyre.

Duke qënë se punimet do të kryhen pandërprerë aktivitetin e përditshëm të punës së drejtorisë dhe në prani të shumë personave afër dhe Brenda kantierit të ndërtimit dhe duke pasur parasysh vendin e ndërtimit, është parë e nevojshme disponimi i ekspertit të ndikimit në mjedis.



Në pikën 4, Nenin 24 të ligjit Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” përcaktohet se licencat e këtyre ekspertëve përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011” Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, Ne baze te Ligjit Nr .9010, date 13.2.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”i ndryshuar pasi licenca me (kodi III.2.B eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve te ngurta.

.2-Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri" (i ndryshuar), i ndryshuar, citohet: “Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta”

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyrues, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në ndërtimet e reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të jetë i licencuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Kategoria I.2.A “Shërbime ekspertize” specifikon shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit.

**2.3.12** Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

a) Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator	Copë	3	Në pronësi ose me qira
2	Fadrome	Copë	3	Në pronësi ose me qira

4	Mjet autovinç	Copë	3	Në pronësi ose me qira
5	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 - 10 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
7	Kamioncine vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 1-5 ton	Copë	8	Në pronësi ose me qira
8	Autobot uji	Copë	3	Në pronësi ose me qira
9	Autobetoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qira
10	Autopomp betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Elektrotranxhe	Copë	3	Në pronësi ose me qira
13	Skela metalike	M2	2500	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
14	Pompa Uji	Copë	1	Në pronësi ose me qira
15	Vibruese betoni	Copë	3	Në pronësi ose me qira
16	Betoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qira
17	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Rul me vibrim	Cope	2	Në pronësi ose me qira

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm);
- b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes . Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore 150 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope

- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

***Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

***Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik **mjetet dhe pajisjet teknike** Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive është bere referuar zërave të punimeve reflektuar në tabelë sa më poshtë: Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

**2.3.13** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi/Distributori, Certifikata ISO Prodhuesi/Distributori, Katalog per :

- Bojerat
- Kamerat
- UPS
- Kaldaja
- Pompa
- Tubacione te ujit te pijshem

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, sipas deklaratës së mësipërme, brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Per materialet e mesiperme AK vlereson si te domosdoshme qe OE te provoje cilesine e materialeve nga prodhuesi/distributori. Kerkesa eshte vleresuar e nevojshme si kerkese teknike pasi objekti qe do ndertohet eshte ndertese publike ku ka levizje dhe prani te shumte te njerezve dhe konsiderohet me rrezikshmeri te larte. Per kete arsye materialet qe do te perdoren ne strukturen e kesaj godine duhet te jene te garantuar sipas cilesise dhe standarteve te kerkuara, prandaj eshte e nevojshme qe AK te garantoje cilesine e ketyre materialeve.

#### **2.3.14 Operatori Ekonomik të ketë 1(nje) punonjës– Auditues Energjitik i Certifikuar me titull: “Auditues Energjitik ne Ndertesa dhe instalime industriale.**

Per punonjes auditues energjitik duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata per audituesin energjitik te leshuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise.

*Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.*

*Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Në bazë të nenit 16, pika 5 b të Ligjit Nr.124/2015 “Për eficientësinë e Energjisë”, citohet: “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.”

Duke u bazuar në objektin e prokurimit I cili ne thelb te tij eshte rikonstruksion me sasi te konsiderueshme punimesh, eshte e nevojshme prania e një audituesi energjie, për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve sipas projektit edhe nxjerrjen e certificates perfundimtare te efijences per objektin ne fjale.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga Studio e projektimit I cili ka hartuar Projektin Objekt Prokurimi. Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

**Fondi Limit i perlogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre''**,

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj"**.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

**Njesia e Prokurimit:**